

VENDIM

Nr.812, datë 10.11.2011

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROVIMIN E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 dhe 13, shkronja "c" të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit, si më poshtë vijon:

a) Për kandidatin që jep provimin për herë të parë 10 000 lekë;

b) Për kandidatin që jep provimin për herë të dytë 12 500 lekë;

c) Për kandidatin që jep provimin për herë të tretë 15 000 lekë;

ç) Për kandidatin që jep provimin për herë të katërt 17 500 lekë;

d) Për kandidatin që jep provimin për herë të pestë 20 000 lekë.

2. Tarifat për provimin e shtetit, të llogaritura sipas pikës 1 të këtij vendimi, arkëtohen para procesit të regjistrimit për provim, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të Postës Shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Kombëtare të Provimeve.

3. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa për provimin e shtetit nga Agjencia Kombëtare e Provimeve derdhen 100% në buxhetin e Agjencisë.

4. Pjesa e të ardhurave që i takon Agjencisë Kombëtare të Provimeve evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 05, "Të ardhurat e veta".

5. Të ardhurat që sigurohen nga këto tarifa menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe përdoren si më poshtë:

a) për pagesën e anëtarëve të grupeve të hartimit të fondit të pyetjeve dhe të Komisionit të Provimit të Shtetit;

b) për të mbuluar shpenzimet për organizimin dhe funksionimin e provimit të shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha